- ❖ Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- ❖ Mobilizimi i menjehershëm i stafit
- ❖ Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- ❖ Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/ aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- ❖ Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- ❖ Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- ❖ Pajisja e zones me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- ❖ Njoftimi i menjehershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).

Personat pergjegjes per zbatim:

- Punonjesit

- Instancat shtetërore të specializuara

11. PËRSHKRIMI I MASAVE TË TJERA PARANDALUESE TË PLANIFIKUARA

11.1 PARANDALIMI I AKSIDENTEVE DHE REAGIMET GJATË EMERGJENCAVE

Bëni një listë të situatave të mundshme, të cilat mund të kenë një ndikim në mjedis.

Përshkruani masat ekzistuese ose të planifikuara, duke përfshirë procedurat e emergjencës që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis të shkarkimeve, në rast të aksidenteve apo rrjedhjeve.

Tregoni se cilat janë masat e reagimit emergjent, të marra jashtë orarit normal të punës (gjatë natës, fundjavës, pushimeve).

Përshkruani procedurat e ndërmarra në raste të jashtëzakonshme (fillimin e aktivitetit, rrjedhje, keqoperimet, ndërprerjet afat-shkurtra të operimit, etj).

Vendosni afatet për marrjen e veprimeve dhe masave përkatëse; jepni informacion mbi personat përgjegjës, në përputhje me Rregulloren për përmbajtjen e raporteve mbi sigurinë, natyrën e informacionit rreth masave të sigurisë dhe përmbajtjen e planeve të ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme.

*Përfshini në **Aneksin 11**, të gjithë informacionet përkatëse që kanë lidhje me sa më sipër.*

Aneksi XI

Gjate ushtrimit të këtij aktiviteti, subjekti do të mbajë parasysh që problemet mikroklimës e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të jenë me të rëndësishmet dhe me të mprehtat, që kërkojnë vlerësim serioz.

Eshtë e domdoshme që për menaxher të pikës të punohet specialiste, me eksperiencë në fushën e njohjes të hidrokarbureve.

Drejtuesi teknik i impiantit, para fillimit të punës dhe gjatë saj, do të zbatojë rregullat dhe normat e përcaktuara në Rregulloren e Teknikës së Sigurimit për naftën dhe nënproduktet e saj. Aktiviteti për transportin, depozitimin dhe tregtimin e naftës rregullohet me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjerë", i ndryshuar

Rregulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të impiantit dhe subjektit privat, do të zbatohen në çdo proces pune të përcaktuar në plan-organizimin, i cili duhet të përmbajë:

- Plan organizimi i funksionimit do të hartohet para fillimit të punës;
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i instalimit;
- Drejtuesi teknik i instalimit, ose personi i ngarkuar, do të bëjë kontrollin teknik herë pas here;
- Në këtë plan tekniko-organizativ, masat e teknikës së sigurimit do të zënë vendin kryesor.
- Punonjësit, që do të punojnë në pikën e furnizimit me karburant dhe gas auto për kontrollin e rezervuarëve, etj do të instruktohen rregullisht dhe do të ndjekin me rigorozitet

zbatimin e

rregullave dhe normave të Rr.T.S., që lidhen me këto probleme .

- Kujdes i vecante do të tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimit të shesheve të depozitave, rrugëve hyrse dalese, etj.

Do të zbatohet një regjim i rrepte në aplikimin e pasaportave teknike të procesit të furnizimit të mjeteve me motorr .

Manikerite duhet të mirembahen teknikisht që zhurma e tyre të jete vetëm ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet të përdoren me efikasitet dhe të minimizohet koha gjatë së cilës mbahen ndezur.

Do të përdoret naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Transporti i hidrokarbureve do të bëhet me mjete të pastra nga balta. Të menjaherë reduktohen borivat e automjeteve nga shoferet për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banorët. Qarkullimi i makinave hyrje dalje të pikës do të bëhet më shpejtësi të ulët gjë që shmanjë jo vetëm aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

Në rast të ndodhjes së ndonjë rrjedhje aksidentale do të merren këto masa:

- Sistemi dhe izolimi i fluidit në barrierën perkatëse.
- Izolimi i mjedisit dhe ndërprerja e punës në impiant.
- Nderhyjme duke e depozituar dhe evaduar për në destinacionin perkatës fluidin e shkarkuar.

12. REHABILITIMI, NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË, RIFILLIMI DHE KONTROLI PAS NXJERRJES NGA PËRDORIMI

Përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis pas ndërprerjes së aktiviteteve në të gjithë instalimin apo në pjesë të ndryshme të tij, duke përfshirë masat për menaxhimin e mbetjeve të mundshme ndotëse, pas mbylljes së instalimit.

*Përfshini në **Aneksin 12**, të gjithë informacionet përkatëse që kanë lidhje me sa më sipër.*

Aneksi XII

Aktiviteti i shfrytëzimit të pikës së furnizimit me karburant dhe gas auto si aktivitet vepron në sipërfaqe të përshtatur mirë për detyrën që ka. Pjesa e relievit ku zbatohet aktiviteti është praktikisht e shtruar me beton e varfer nga mungesa e bimësisë.

Për vetë specifikën dhe projektin e zbatuar për këto aktivitete (kompleks) është mendur që të mos ketë kthim mbrapsht, por nëse do të ketë, kjo do të bëhet me një plan të mirëstuduar e miratuar nga organet kompetente.

Disa nga masat e rehabilitimit pas mbylljes së instalimit nëse ndodhe:

1. Çmontimi i teknologjisë nga eksperte për të evituar kontaminim të tokës, rrjedhje atj.
2. Heqja e të gjithë materialeve inerte nëse do të mbyllet aktiviteti nga operatore të licencuar.
3. Largimi i të gjitha mbetjeve të hekurta nga sipërfaqja e shfrytëzimit për instalim nga operatore të licencuar.
4. Mbjellja me fidane autoktone të zonës.

13. PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Shtojca 2

Përshkruani planet ekzistuese ose të propozuara për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë tentative e trajtimit/menaxhimit në mjediset e instalimit.

Përfshini në **Aneksin 13**, të gjithë informacionet përkatëse që kanë lidhje me sa më sipër.

Aneksi XIII

Plani i menaxhimit të mbetjeve

Prejardhja e mbetjes	Lloji i mbetjes I	Menaxhimi I mbetjeve	Risku rrezikut I	Personi pergjegjes
Mbetje qe vijne si rezultat i aktivitetit te punonjesve ne ambientet e punes	Leter dhe karton 20 01 Mbetje te biodegraduesh me 20 01 08 Plasikat 20 01 39	Ne territorin e brendshem te kompanise jane vendosur koshat per depozitimin e mbetjeve. Nje nga politikat e brendshme te kompanise per menaxhimin e integruar te mbetjeve eshte vendosja e koshave me ngjyra per te ndare ndare mbetjet qe ne burim. Koshat pastrohen ne menyre te rregullt dhe nuk arrijne asnjeher ne piken maksimate te volumit te tyre, gje kjo e cila sjell minimizimin e ndonje arome te mundshme. Dergimi I tyre ne menyre periodike ne vendet e percaktuara nga pushteti vendor. Perdorja e materialeve te riciklueshme nga ana e punonjesve	Keto mbetje cenojne ekosistemin dhe ndikojne ne shume faktore mjedisore, por miremenaxhimi I tyre dhe reduktimi I tyre ne mase ka nje qasje positive.	Punonjesit Menaxheri
Mbetje te lengeta	050103 Llumra të fundit të depozitave	Ne territorin e brendshem te kompanise jane vendosur ene te posaqme per depozitimin e llumrave te hidrokarbureve. Pas kesaj ata dergohen ne kompani te licencuara per riciklimin dhe asgjesimin e tyre.	Keto mbetje cenojne ekosistemin dhe ndikojne ne shume faktore mjedisore, sidomos ne ambjente sheshe, dhe ujjra nese bien ne kontakt me to	Administratori Menaxheri

14. Përmbledhje Jo-Teknike

Paraqisni një përmbledhje të kërkesave për leje mjedisi, pa specifikuar detajet teknike.

Përmbledhja duhet të identifikojë të gjitha efektet mjedisore të njohura, të cilat kanë lidhje me kryerjen e aktiviteteve në instalim, dhe përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis.

Ky përshkrim duhet të përmbajë oraret dhe ditët normale të punës për kryerjen e operacioneve gjatë një jave.

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

Përshkrimi:

- Instalimi dhe aktivitetet e tij;
- Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;
- Burimet e shkarkimeve nga instalimi;
- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;
- Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;
- Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;
- Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;
- Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);
- Masat për përdorimin eficient të energjisë;
- Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:
 - a) janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
 - b) janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme
- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

- Subjekti "BESARDI" sh.p.k i regjistruar pranë QKR, me NIPT: J98009208R, me zyrat qendrore në **Kukes; KUKES; KUKES; Lagjja 'Nr 2'; Rruga "Gora"; Zona kadastrale Nr. 2315; Nr. Pasurie 50/67.** me administrator Z. Kadri DURAKU krahas aktiviteteve të tjera në këtë prone do të zhvillojë aktivitetin e tij "**Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.**", në rrugën "**Gora**", Lagjja **Nr.2**, Kukes.
- Objekti i shoqërisë është Pikë furnizimi me karburant dhe gas Auto, etj.
- Tregu i hidrokarbureve është një aktivitet i gjere që përfshin si sferën e prodhimit të tyre, ashtu dhe atë të shitjes të tyre. Tregtimi i NAFTAES dhe nënprodukteve të naftës kap një zinxhir të gjatë, që fillon që nga prodhuesit e tyre e deri në rafineritë të naftës, kalon në sferën e qarkullimit të tregtimit me shumicë e përfundon në pikat e shitjes me pakicë.
- Për të patur një aktivitet me bilanc gjithnjë pozitiv krahas konjunkturës së tregut dhe luhatjes së çmimit të hidrokarbureve një rendesi të veçantë merr depozitimi dhe magazinimi me standarte I produkteve në depozita të projektuara dhe veçanërisht të ndërtuara sipas kërkesave dhe sa me bashkëkohore.

Subjekti, për ushtrimin e kësaj veprimtarie do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij.

Objekti furnizimi me karburant dhe gazi auto per automjete me garniture benzine e super benzine ,Eurodiesel te standartit Europian. Keto jane te magazinuara ne cisterne celikute te futura ne toke dhe te fiksuara, te mbuluara sipas kushteve e normave teknike

Janë gjithsej tre depozita sejcila me 20m³ dhe një depoitë sipërfaqore 5000 litra për furnizim të mjeteve auto me GNL

Kapaciteti depozitues do te jete sipas normave te ndertimit te karburanteve brenda vijave te verdha te qyteve, urbane.

Është i instaluar nje kapacitet depozitues prej 60 000 litrash, perkatesisht 40 000 litra diesel, 20 000 litra benzine. Ky kapacitet eshte komforme normave te projektimit per karburantet ne zona urbane. Sipas projekteve tip te pikave te karburantit elementet e tjere perberes te saj jane: pompat e furnizimit te makinave te vendosura ne bazament betoni (ishulli I pompave), mbulesa e pikes (tenda) me dimensjone te pershtateshme, ambjente zyre magazine, garderobe si dhe te tjera sipas normave.

Objekti eshte pajisur me sistem depozite uji rezerve vol.2.000 litra per perdorim emergjent ne rast zjarri ne lokal apo zyre, SHOQERUAR me pajisje te tjera te MNZ, si fiksa shkumepulhur me hedhese uji etj. Objekti do te kete sistem drenazhi per ujrata e bardha, pusete me mbyllje per ujrata si dhe kuneta shkarkimi per ne rrjetin e kanalizimeve te qytetit.

Sheshi është shtruar dhe sistemuar me asfalto-betonte te njejtin model si dhe rruga, si ai egzistues per te ruajtur te njejtin sistemim. Bordura siguron shkeputjet nga hyrja e dalja e automjeteve do te ruaje anen funksjonale dhe qarkullimin e lire dhe mbrojtjen nga kalimi i mjeteve. Objekti do te kete te gjitha elementet e tjera te domosdoshme dhe ndriçimin-sinjalizimin, per punen naten ne kushte normale.

SHESHI I NDERTIMIT DHE ELEMENTE TE VENDOSJES

OBJEKTI : PIKE KARBURANTI eshte vendosur ne sheshin e hapur te tokes ne pronesi sipas dokumenteve perkatese te pronarit firmes me siperfaqe te mjaftueshme . Kjo vendosje do te behet sipas projektit perkates, ne te cilin jane dhene te gjitha elementet baze te ndertimit. Ne projekt jane patur parasysh distancat nga objektet e tjera perreth,si: rruga kryesore, kryqezimi dhe te tjera objekte qe mund te ngrihen. Pika e karburantit do te jete nje objekt ku te gjithe elementet perberes te tij do te sigurojne nje funksjonim unik dhe te kontrollueshem . Distancat e sigurise se brendshme e te jashtme te objektit jane ne perputhje me kushtet teknike te ndertimit te pikave te karburantit Brenda qendrave te banuara. Keto norma jane ruajtur gjate zbatimit te ndertimit te objektit dhe gjate punes ne te.

ELEMENTET PERBERES TE PIKES SE KARBURANTIT

DEPOZITAT (cisternet) e karburantit me lidhjet perkatese teknologjike lidhen me pompat dhenese per te furnizuar dhe me tuba te tjere mbushen nga autoboti kur vjen furnizimi . Te gjitha tubacionet vendosen ne toke me lidhje me fileta dhe hermetizim te posacem. Tubacionet jane prej tubash te zinguara me diameter 38mm (1-1/4”), gjithashtu edhe ato te ajrimit.me valvolat perkatese.

Te gjitha elementet e ndertimit te pershkruara me lart ndertohen me materjale te padjegeshme per nje zgjatje kohe 2 ore. Çisternet e karburantit si objekti me i rendesishem I investimit jane te ndertuara prej celiku me trashesi llamarine 6 mm me saldim me teknologjine e saldimit te eneve ne presjon e nga saldatore te patentuar.

Nga brenda jane te perforcuara me profile L50 ne forme trekendeshi. Per ti mbrojtur nga korrozjoni i jashtem cisternet hidroizolohen me shtresa mastike bitumi sipas receptures perkatese. Cisternet vendosen ne toke ne mbeshtetese (jasteke) betoni ne lartesi 30 cm. Gropa e cisterneve eshte kafaz betoni me trashesi 20 cm dhe mbulese solete betoni me daljet ne grykat e cisterneve. Grykat e cisterneve jane te mbuluara me kapake metalike dhe te izoluar. Ne grykat e cisterneve dalin te gjitha tubat : ai i thithjes, i mbushjes ,imatjes se nivelit dhe i ajrimit. Çisternet jane 3 cope me diameter 230 cm, e gjatesi 500 cm,

Çisternet fiksohen ne bazamente me shirita celiku per te evituar ngritjen e mundeshme nga permybtja e gropes nga ujrat ne raste te mbushjes me uje. Kapaket e cisterneve jane te mberthyer me bullona dhe me guarnicjone per hermetizim. Fundet e cisterneve jane te kupolare te stampuara me diameter $d = 2600-2700$ mm dhe prodhim i importit. Ne pjesen me fundore te cisterneve ka tape per pastrim te mbetjeve qe mund te dekantojne me kalimin e kohes.

POMPAT. Jane te prodhimit perendimor me sasi dhenese 0.6-1lit/sekonde me system thithje nen vakum nga cisternet dhe me valvol fundore ne thithje .Ato kane sistem takimstakimi me presostat, me motor elektrik hermetik dhe me sistem elektrik antideflagent.

Sistemi i tokezimit mbron pajisjet nga masat dhe elektriciteti statik. Pompat jane te unifikuara me matesin e sasise se dhenies se karburantit ne nje kasete te perbashket. Ato jane te kolauduara dhe te taruara per te dhene sasine e caktuar te karburantit ,e cila munde te kontrollohet ne çdo kohe nga inspektoriati i peshematjes.

TENDA. Mbulon zonen e futjs se mjeteve per furnizim dhe ka dimensionet 16 x16 m me lartesi 4.8 m..

Eshte e ndertuar me konstruksjone metalike dhe veshje llamarine te profiluar per ti dhene dhe pamje estetike e funksjonale. Eshte e pajisur me ndricuese "te ftohte" me gypa neoni per nje ndricim te bollshem jo verbues, sipas rregullave te sigurimit teknik.

ZYRA- ambjentet jane te vendosura ne pjesen e mbrapme te objektit dhe i sherbejne personelit duke mbajtur edhe mjete te domosdoshme si dhe vajra lubrifikante te amballazuara per automjetet. Instalimet e zyrave jane komforme normave e rregullave teknike dhe te MNZSH.

SISTEMI I KANALIZIMEVE. Siguron nje largim te shpejte te ujrave te rreshjeve duke i shkarkuar ne pusetat e ujrave te rruges. Ai eshte i mbuluar me zgare metalike gjate gjatesise se tij.

Sheshi i qarkullimit eshte me pjerresine e duhur per cvendosjen e ujrave drejt kanalizimeve.

REKLAMA. Vendoset ne pozicjon te pershtatshem dhe eshte me permasat sipas normave, me funksionin dhe qellimin e caktuar. Ajo permban produktet çmimet e tyre dhe emblemen e shoqerise qe do te furnizojë pronarin e pikes.

Te gjitha keto perbejne elementet e kompozimit te nje pike karburanti bashkekohore qe do te sherbeje furnizimit te automjeteve qe qarkullojne ne ate zone.

SISTEMI I MNZ. Eshte pjese e domosdoshme e objektit per vete natyren e punes me produktet e naftes si burim zjarri. Per kete arsye objekti do te pajisert me mjetet e domosdoshme te MNZ te cilat jane :cisterne uji rezerve me volum $2m^3$ e vendosur ne kuote $h=5$ m, pompe dergimi uji ne tubacione , tubacionet e shtrira ne pika me manovrues eper fikje zjarri eventual, si dhe rubineta me hidrante per hedhje uji me tubo ne distance. Eshte vendosur kaseta me mjetet e shuarjes se zjarrit si dhe veglat e zakonshme te perdorimit ne rast zjarri si kazme, lopate, rere dhe fikset portative me shkume e pluhur fosil, te cilat jane vendosur prane pompave dhe ne kasetene MNZ.

PUNIMET E MONTIMIT. Jane kryer nga brigade e specializuar si per punimet ndertimore dhe ato metalike. Gjate punimeve te gjitha mbetjet si inerte dhera dhe mbeturina te saldimeve te pastrohen e te largohen nga mjedisi. Te behet rehabilitimi dhe sistemimi i terenit ne vecanti e trotuarit si dhe krijimi i nje mjedisi te gjelberuar sipas zgjidhjes arkitektore te projektit.

FUNKSIONIMI. Para mbushjes se cisterneve me karburante behet kolaudimi i pajisjeve dhe prova e presimi i tyre me uje dhe vetem mbasi te konkludohet per hermetizim te plote te tyre pas pastrimit behet mbushja e tyre me karburante. Volumi i mbushjes se cisterneve duhet te jete jo me teper se 90% te volumit gjeometrik te tyre. Mbushja nga autoboti behet me veterrjedhje, por jo me hapje te plote te saracineskes per te lehtesuar daljen dhe zevendesimin e ajrit te cisterneve. Asnjehere nuk duhet te ngaterrohet mbushja e cisternes me karburant tjetere ose me karburante jashte standartit. Ne cdo kapak te cisternes duhet te jete i shkruajtur lloji i karburantit qe mban. Nderrimi i karburantit ne bote te behet vetem pas larjes se tyre ose te silltet me bote te vecante. Pas mbushjes se cisterneve behet mbyllja e kapakeve te tyre. Pas kesaj, mund te provohet thithja me pompe me shkarkim ne nje kove. Ne kete menyre, behet edhe furnizimi i cisterneve te tjere. Asnjere nuk duhet te boshatisen krejtesisht cisternet dhe pompat te marrin ajer. Pavaresisht nga keto, projekti i dhene dhe punimet e montimit do te realizojne keto pika shitje karburanti funksionale dhe bashkekohore.

Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përherë nga projekti, gjatë funksionimit të veprimtarisë

- Objekti ka nje siperfaqe prej $680 m^2$ i pozicionuar ne krahun e djathte te rruges Gora e te majte te rruges Prizereni . Hyrjet e daljet për në pikën e furnizimit me karburant përmbushin normat e funksionimit simbas rregullores se RSH për hidrokarburet dhe Sistemin rrugor.
- Objekti është rreth 0.9 km ne veri te saj dhe 1.5 km ne Perendim nga Liqeni I Fierzes,
- Objekti Pikë e furnizimit me karburant me vend ndodhje rruga “Gora”, Lagjja “Nr. 2” juridiksion të njësisë Administrative Kukes, Kukes ndodhet 30 km në Jug Lindje te pikes doganore Morin me Kosoven

- Në Lindje është Ajoporti I Kuksit ne nje distance vije ajrore rreth 3 km dhe rrugore 4 km.
- Jugperendim te pikes ndodhet tuneli I kalimashit ne distance 14 km.
- Ne veri dhe ne perendim te pikes se karburantit ndodhen urat hyrse te qytetit perkatesisht ajo e hasit rreth 1.2 km larg dhe ajo e Tiranës 1.6 km larg



4- Perputhja e aktivitetit me ligjet qe mbrojne mjedisin.

- Ndertimi dhe shfrytëzimi i objektit është mbështetur mbi Legjislacionin shqiptarë ku baza kryesore është Ligji Nr. 8990, datë 03.01.2003 “Mbi impaktet mjedisore” i cili përcakton procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM në Republikën e Shqipërisë.
- Një vlerësim i tillë harmonizon impaktet ambientale të projektit duke realizuar dhe parandaluar efektet negative duke i menjanuar ato në kohën e duhur.
- Për këtë projekt, në mbazë të nenit 26 i ligjit nr. 8990 është marrë edhe pëlqimi i publikut duke plotësuar kështu kërkesat e legjislacionit të ambiental dhe direktivave përkatëse të BE.
- Rregulloret më të rëndësishme dhe ligjet e aplikuar për VNM-n janë si më poshtë:
- Zbatimi me rigorozitet i Kushteve teknike të projektimit, dhe Zbatimit, Mbrojtjes kundër zjarrit, dhe sigurimit teknik në punë .
- Ligji Nr. 8093 “Për burimet e ujërave” ligjeve Ligjet Nr. 8375, 8605, 8736, Ligjin Nr. 8897 “Për mbrojtjen e ndotjes së ajrit” etj.

- Zbatimi i kushteve teknike dhe normave te projektimit te depozitave Objekti i mare ne analize ne perputhje me rregullat per projektimin dhe zbatimin e ndertimit te depozitave per karburante dhe lende djegese per tregetim me shumice ku i referohet normave dhe kushteve teknike ne fuqi te miratuara nga shteti shqiptar.
- Keto akte normative percaktojne rregulla dhe udhezime si per kapacitetet depozituese ashtu dhe per anet dimensionale te rezervuareve .Gjithashtu jepen elemente te vendosjes ne sheshin e ndertimit distancat midis rezervuareve ,dhe objekteve te tjere te depozitave si ndertesa zyra, pikat e ngarkim shkarkimit te çisterneve rrugore ,argjinaturat e sigurise, sistemin e dekantimit, rruget e qarkullimit dhe lidhjet e tyre me rruget e jashtme .
- Te gjitha keto elemente te perberjes se depozitave jane te percaktuara dhe studiuara ne baze te normave te vendosura per distancat e sigurise se brendeshme dhe te jashteme te objektit.
- Distancat e sigurise se jashteme percaktojne, sa eshte distanca minimale per vendosjen e nje sistemi depozitash nga objekte te tjera si: aktivitete industriale, tubacione magjistrale nafte apo ujesjellesi, qendra te banuara urbane apo rurale e deri ne ndertesa te veçuara ,nga linja elektrike TL ose TU. Keto distanca duhet te merren ne konsiderate per nje vendosje sa me optimal dhe pa shkaktuar probleme per objekte te tjera me rrezik eventual dhe ne veçanti per qendrat e banuara. Duke u nisur nga anet negative dhe mundesite per lindje zjarresh dhe rendimin e mjedisit, per zonat e banuara keto distanca meren maksimale, krahas zgjidhjeve dhe arritjeve teknike te projektit te zbatimit.
- Distancat e sigurise se brendeshme presupozojne ato qe u klasifikuan me larte d.m.th distancat midis elementeve perberese dhe objekteve te depozitave. Krahas distancave me karakter konstruktiv dhe funksional ,keto distance ju referohen normave te sigurise nga zjarri, si ngjarja me e rende ne nje objekt te tille te rendesishem.
- Gjithashtu jepet distance midis mureve te betonit nga faqet e rezervuareve ,lartesia e mureve dhe elemente te tjere si shkalle ne rezervuare e te tjera.
- Ne rastin e depozitave tona disa elemente te sigurise se brendeshme mund te meren minimale per aresye te marrjes se masave te mbrojtjes nga zjarri me zgjedhjen e konstruksioneve te pershtateshme te ndertimit.

Vleresimi i Ndikimeve

Procesi i vleresimit te ndikimit ne mjedis siguron nje permbledhje te informacionit te disponueshem ne perputhje me kushtet e vendodhjes se vepres duke perfshire kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, kulturen dhe kushtet social ekonomike te zones. Ne kete proces vleresimi te ambientit, informacioni per kushtet e vendodhjes se vepres se bashku me standartet dhe normat e aplikueshme jane perdorur per vleresimin e potencialit ambientor dhe te ndikimeve sociale per objektin e propozuar.

Ndikimet potenciale mjedisore te trajtuara ne procesin e vleresimit te ambientit perfshin ndikimet per ajrin, burimet ujore, burimet tokesore dhe kushtet social ekonomike dhe kulturore gjate operimit , shoqeruar me infrastrukturen.Vleresimi i kushteve socialkulturore perfshin punesimin, perdorimin e tokes, burimet per materialet baze, transportin dhe sherbimet per komunitetin lokal.

1 Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objekteve te ndertuara nga njeriu

Ndërtimi i objektit ndikojnë edhe në drejtim të mjedisit human.

Ndryshimet ne popullsi.

Vendndodhja e projektit ëahre në një zonë pranë qeëndrave të banuara dhenë rrugë lidhëse me këto qëndra kështu që aktiviteti ndikon direkt pozitivisht në qënjen humane si për shërbimet që ai ofron dhe për punësimin njerëzve banër të zones

2 Ndikimet e dukshme te projektit te zhvillimit ne zonat rrethuese dhe pejisazh.

Aktiviteti veç ndryshimit mjedisor si rezultat i ndryshimit të karakterit të tokës në truall për aktivitet me karkater ekonomik e hoteleri Ky ndikim është shumë planësh. Ai mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, sikurse mund të jetë negativ, ashtu edhe pozitiv

Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga projekti i zhvillimit gjate fazes normalete operimit.

Zhvillimi i projektit ka parashikuar masa te repta konform legjislatures ne fuqi per ruajtjen dhe administrimin e karburanteve. Ndikimet potenciale nga magazinimi dhe dorezimi i lendes djegese do te lehtesohen nepermjet perdorimit te praktikave me te mira menaxhuese, te cilat jane praktika qe njesi publike dhe private adoptojne per parandalimin e ndotjes ne operimet e tyre. Nje plan dhe paisje te nevojshme jane siguruar per t'iu pergjigjur funksionimit te impiantit .

Subjekti eshte pergjegjes per pergatitjen e ketij plani gjate funksionimit te vepres dhe per te siguruar paisjen e nevojshme per tu pergjigjur ne te tilla raste.

Monitorimi dhe kushtet e traspoetit sipas te cilave nje trailer mund te beje dergesa duhet te jene pjese e procedurave te subjektit dhe te implementohen nepermjet kontrates derguese. Nje mbajtjes sekondar duhet te sigurohet per tankerat e lendeve djegese.

3 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti zhvillues. Zhurmat e emetuara nga operimi i do te jene sipas standarteve nderkombetare te 70dB per zonat tregtare/industriale.

Ne bazen e furnizimit do te ket levizje te vazhdueshme te automjeteve te cilet do te sjellin lende te pare dhe do te terheqin neproduktet . Si ne rastin e furnizimit , ate te depozitimit dhe ne rastin e shperndarjes faktori i ndikimit te zhurmave do te jete i pa ndieshem dhe ne asnje rast nuk do ti kaloje 85 dB(A).

4 Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin.

Kemi permendur ne kapitujt e mesiperme se objekti ndodhet ne teritorin e bashkise dhe sote eshte ne aktivitet. Keshtue per tui pergjigjur nevojave subjekti do te investoje per permirsimin e parametrave te kesajrruge njekohesisht ne vazhdimesi do te bej mirmbajtjen e saj. Keshtu qe indirekt i sherbehet komunitetit duke lehtesuar transportin ne kete segment rrugor.

5 Ndikimet e projektit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore, psh si pasoje e ndotesve, shqetesimeve vizuale, vibracionit.

Per vec fazes ndertimore nje rendesi te vecante do ti kushtohet vendosjes se armatuara dhe aparateve e tubacioneve.

Vendosja e armaturave dhe aparateve ne rezervuare dhe tubacione.

Depozitat dhe tubacionet pajisen me nje numur te caktuar armaturash si saraçineska, valvola, valvola sigurimi ,kompensimi, manometra,ventila te domosdoshme per manovrimet mbyllje hapje sipas rrugëve te kalimit te lengut. Keto armatura duhet te jene te manovrueshme dhe cilesore, per tju pergjigjur operacioneve te vazhdueshme te punes. Armaturat ne teresi sipas vendit dhe pozicionit te vendosur duhet te specifikohen sipas natyres se punes . Ne pergjithsi ne depozita per nga rendesia e punes dhe sherbimit vendosen armatura me trup prej çeliku dhe me pak prej gize ose metale te bardha. Prandaj nuk duket lejuar e toleruar shkelja e kesaj kerkese e norme teknike,pasi nje demtim i nje armature ne rezervuarmund te shkaktoje rrjedhjen e sasive dhe humbje te produktit me vlera te medha monetare.

1.Shkarkimet ne mjedis dhe mbetjet

1.1 Shkarkimet ne ajer

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A ka shkarkime në ajër (nga oxhaqet)		jo	
A ka shkarkime në ajër (nga burime të shpërndara)?	po		Shkarkime ne ajer ka vetem ne momentin e furnizimit te depozitave dhe kryesisht ato te benzines ne kete raste shkarkimet jane pak te ndieshme dhe nuk ndikojne ne ambientin rrethues se jemi large qendrave te banuara
A ka erëra të pakëndshme nga shkarkimet?	po		Po erëra te keqia ka vetem ne rastin e furnizimit me gas te lengeshem

1.2 Shkarkime te ujrave te ndotur

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A ka shkarkime të ujërave të ndotura?	po		Shkarkimet e ujrave t ndotura do te kalojne para shkarkimit ne dekantues ku mblidhen mbetjet vajore pastaj si ujra teknologjik derdhen ne rjetin e kanalizimeve te zones
A ka ujëra të ndotura me natyre toksike?		jo	
A bëhen shkarkime në rrjetin e kanalizimeve?	po		Per mirmbajtjen e ambienteve ujrut do te rjedhin ne rjetin e kanalizimeve por keto nuk jane me mbetje te demeshme
A bëhen shkarkime në sipërfaqet ujore?		jo	

Shtojca 2

Jepni sasinë e ujërave të ndotura (m3/ditë)	Rreth 1-2m3 ujra per pastrimin e ambienteve
---	---

1.3 Zhurmat & vibracionet

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A gjenerohen zhurma?		jo	
A gjenerohen vibracione?		jo	

1.4 Mbetjet e ngurta

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A gjenerohen mbetje të ngurta?	po		Mbetjet urbane
A gjenerohen mbetje të ngurta të rrezikshme?		jo	
Të asgjësuar në territorin e impiantit/instalimit?		jo	
Përshkruani mënyrën e asgjësimit			

Ndikimet ne ajer dhe ne klime

Niveli dhe perqendrimi i emetimeve kimike dhe ndikimet e tyre mjedisore. Produktet hidrokarbure dalin nga distilimi ne temperature dhe presione dhe kane kane nje diapason kalimi nga nje produkt ne tjetrin dhe nga nje gjendje fizike ne nje tjetere me ndryshim te temperatures, pra jane ne vartesi te saj, kjo sidomos per produktet e pangopura te series se metanit ku futen pergjithesisht benzinat. Kjo e eshte marre ne konsiderate qe ne projektimin e depozitave te benzines, ku qysh ne projekt eshte parashikuar ruajtja e pandryshuar e gjendjes fizike te saj.

Rritja e temperatures ne hapsirat e depozites sjell rezultat fenomenin e avullimit dhe rritjen e tensionit te avujve ne hapësirën gazore dhe si dhe daljen e avujve ne atmosfere, duke ndikuar keshtu prishjen e ajrit dhe ndikimin ne ndotjen e mjedisit ne zonen e Per evitimin e ketyre ndikimeve Rezervuaret jane parashikuar te pajisen me sisteme valvolash sigurie e shfryrje ose me sisteme kompensimi te presionit me qarkullim gazesh inerte ose hidrokarbure ne hapësirëngazore te rezervuareve. Do te ushtrohet kujdes qe ne rezervuaret e produkteve te lehta te benzinave temperatura do te mbahet ne nivele normale nen 25 0 C. Ne projekt eshte zgjidhur nepermjet nje sistemi nepermjet qarkullimit te ujit ne kupolen e depozitave të benzines dhe te gazoilit kur temperatura kalon 40 0C, Koto masa jane mare mbasi keto fenomene jane prezentekur temperatura e mjedisit rritet mbi 25 ° C, sidomos gjate stines se veres, ndersa kur temperaturae mjedisit eshte nen 25°C fenomeni i avullimit eshte jo i ndjeshem.

Lendet e vecanta. Ne procesie lende ve e vecanta nuk mund te pershkruajm si lende te vecanta

mbasi te gjitha nenproduktet e naftes jane te karkaterit hidrokarbur por gjithmon uljen e ketyre ndikimeve parashikohen ne projekt ku eshte e domosdoshme zbatimi me rigorozitet i procesit teknologjik.

Aromat sulmuese. Gjate shfrytezimit te objektit do te kete dhe ndikime ne ndotjet si rezultat e daljes se ajer i ndotesave aromatik te nenprodukteve te lehta hidrokarbure. Kjo influence eshte gjithmon e kontrollueshme dhe dhe pasojaartt nuke jane me rezik per njerzimin mbasi produktet kimike helmuese si H₂S squfuri apo ndonje element tjeter i demshme largohen qe ne fabriken e perpunimit te hidrokarbureve keshtu qe hidrokarbure e trasportueshme ndotin deri diku ne ambientin po pa rezik per punonjesit.

Ndikime te tjera klimatike. Ne kete rast duhet te merret ne kosiderate ndikimet qevijen si rezultat i ngritjes se temperaturave te larta ne kohen e dimirit per kete me rigorozitie duhet te zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri.

Mbrojtja nga zjarri

Per rritjen e sigurise se punes ne depozitat nje rendesite veçante merr zgjidhja sa me e sakte dhe e arrire me projekt e masave per mbrojtjes nga zjarri.

Per masat e mbrojtjes nga zjarri merret ne Konsiderate kapaciteti depozitues, lloji I karburantevedhe lendeve djegese qe do te tregetohet.

Per rastin e pikes ne karburantit ne të Grand Kuç Petrol do te instalohet nje impiante zjarrfikes stacionere i kompletuar me te gjitha elementet e domosdoshme qe nga burimi i ujit ne sasi te mjaftueshme e deri tek llojet e lendes shuarese, shkumes dhe aparateve hedhes edhe perpunuese te shkumes ne rezervuare .

Per projektimin dhe zbatimin e nje sistemi zjarrfikes behen llogaritje te posaçme. Keto llogaritje percaktojne norma per sasine e ujit teknik te domosdoshem qe do te stacionohet ne menyre te perhershmene nje rezervuar te veçante.

Percaktohet sasia e lendes shkume formuese qe instalohet ne depozite.Llogaritet fuqia dhe prurja e pompave te ujit shuares dhe perzjeres te shkumes. ,presioni dhe numri i tyre.Te gjitha keto kapacitete percaktohen sipas nje skenari me te veshtire te nje renie zjarri, ne nje depozite me te madhe dhe me karburante.

Ne baze te kesaj skeme rrjedhin te gjitha llogaritjet per ujin shuares te zjarrit brenda depos se ndezur,sasine e lendes shkume formuese te domosdoshme ne baze te sipërfaqe se rezervuarit, numrin e dhomave te futjes se shkumes ne rezervuar dhe mbi te gjitha numrin dhe kohen e domosdoshme per çdo goditje me uje dhe shkume,ne baze te normave zjarrfikese te konsumit te ujit, per shuarje zjarri dhe per ftohjen e rezervuareve te tjere per rreth tij.Jepen sasite e percaktuara te ujit te domosdoshem per formimin e shkumes ne raportet 94%-6% uje – solucion shkume si dhe sasite dhe litrazhii ujit per m² sipërfaqe rezevuari 1.5 -3 litra /min/ m² apo ml perimeter te tij dhe rezervuarve te tjere.

Krahas futjes se shkumes ne rezervuarduhet nje rryme e vazhdueshme uji per te mbajtur te ftohte trupin e rezervuarit qe te mos deformohet dhe çahet. Fluksi I ujit llogaritet ne litra per sekonde per çdo / m² te trupit te rezervuarit gjate gjithë lartesisë dhe mbuleses se tij. qe jepet nga 2-3,5 lit/minute/m², per nje kohe prej 1 ore. Keto jane kerkesat e konsumit te ujit ftohes.

Per te pergatitur shkumen per ne brendesi te rezervuarit te ndezur duhen te formohen raportet 90-94% uje dhe 6-10 % solucion shkumogjen.

Ne teresi projekti identifikon te gjitha paisjet e domosdoshme qe do te vendosen si dhe origjinen e ardhjes, furnizimit te tyre. Me keto zgjidhje realizohet nje projekt bashkekohor

krahas atij tendertimit te depozitave .Kjo do te siguroje nje ecuri normale te punes, pa anomali dhe ne kushtebashkekohore sherbimi.Ne te ardhmen do te behen pershtatje ne skeme per ta automatizuar dhe kompjuterizuar me bllok skemen e shfrytezimit te depozitave.

Baltrat qe dalin nga pastrimi i pusetave te lavazhit me vënien e lavazhos bë punë dhe ato qe sjellin automjetet me gomat e tyre dhe qe eventualisht shkeputen dhe bjene ne ambientin e stacionit.Ato nder te tjera, mund te permbajne gjurma hidrokarburesh, barishte te ndryshme, etj.

Keto shplahen me uji dhe rrjedhin ne kanal in e ujrave , te bardha dhe me tej perfundojne ne kanal in kullues. Llumrat qe dekantojne ne fundet e rezervuareve te cilat shkarkohen ne nyjet. Futen ne nje fuci ku dekantojne dhe ndahet perseri nje pjese e gazoilit, i cili riperdoret. Llumrat shkarkohen ne kanal. Jane praktikisht pa ndonje ndikim per t'u vene ne dukje.Pikia nafte qe eventualisht mund te dalin nga pistoleta pas perfundimit te mbushjes se automjetit. Keto jane ne sasira krejt te paperfilleshme. Ato bjene mbi shesh dhe pjeserish avullojne ose thithen nga shtresa e sheshit dhe me pas lahen. Avujt gazoilit dhe te benzines, qe dalin nga tubat e "frymemarrjes" se depozitave. Keto dalin ne ambient te lire ne lartesi dhe shkarkohen ne mjedis ne nyjet Jane ne sasira fare minimale. Avujt qe clirohen nga avullimi i pikave te gazoilit qe eventualisht te dalin ne mjedis nga pistoletat e shkarkimit. Gjate punes se automjeteve, qe qarkullojne neper sheshin e objektit per t'u furnizuar ose per transport materialesh te ndryshme, clirohen gaze te djegies, te cilat jane fare te rralla dhe nuk perbejne problem pertu vene ne dukje. qe krijohen nga puna e maqinerive dhe pajisjeve gjate procesit te punes se objektit jane ne nivel shume te ulet dhe te paperfilleshem edhe per personelin qe punon aty, ndersa per mjedisin rrethues as qe behet fjale.Kjo per vete faktin qe maqinerite dhe pajisjet jane ne sasi shume te vogel, me fuqi relativisht te ulet dhe punojne ne menyre periodike.Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare qe shoqerojne projektin.

Ndikimet e projekteve te tjera qe shoqerojne projektin e dhene, si psh., rruget e reja, kanalet e ujrave te zeza, banesat, linjat e energjise, telekomunikacionet, etj.

Masat zbutese

Te identifikohen masat per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis duke dhene disa alternativa per veprimtarine qe do te ushtrohet. Atje ku jane identifikuar ndikime negative te dukshme, te pershkruhen masat qe do te merren per te menjanuar, zvogeluar ose ndrequr ketondikime.

a. planifikimi i zones; Nga analiza e mësipërme vërejmë se gjatë veprimtarisë së ndërtimit të objektit dhe venies se tij ne shfrytezim ekzistojne disa faktorë të cilët kanë mundësi potenciale të ndikojnë negativisht në mjedisin e zonës dhe më gjerë. Në qoftë se gjatë veprimtarisë së shfrytëzimit i kushtojmë kujdesin e duhur këtyre faktorëve, për t'i patur vazhdimisht nën kontroll, ky ndikim është e mundur të minimizohet në maksimum.

b. masat teknike, psh.: procesi selektiv; riciklimi; trajtimi dhe kontrolli i ndotjes.

Si gjate ndertimit ashtu dhe ne fazen e shfrytezimit është parashiukuar ndjekja me kujdes e Programit të Menaxhimit Mjedisor i cili merr në konsideratë dhe analizon të gjitha llojet e ndikieve dhe masat e nevojshme për eleminimin e tyre. Në qoftë se gjatë veprimtarisë së shfrytëzimit i kushtojmë kujdesin e duhur këtyre faktorëve, për t'i patur vazhdimisht nën kontroll,ky ndikim është e mundur të minimizohet në maksimum.

c. masat estetike dhe ekologjike, si psh. modeli, ngjyra, etj.; pejisazhimi; mbjellja me peme;

masat per ruajtur habitatet ose per te krijuar habitate alternative; regjistrimi i zonave arkeologjike; masat per te ruajtur zona ose ndertime historike.

6.1- Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.

Analiza e perdorur per te permbushur kerkesat e VNM (Vleresimi I Ndikimit ne Mjedis) eshte sipas standarteve nderkombetare. VNM vendos kushtin fillestar mbi vendin dhe vlereson ndikimin e facilitetit gjenerues te propozuar mbi burimet e zones. Ndikimet e mundeshme pozitive dhe negative te ketij projekti te propozuar jane identifikuar dhe matur duke parashikuar mundesine me te madhe te ndodhjes se tyre.

Ky impiant gjenerimi eshte nje gjendje e ngritur ne art e njesise se ciklit te kombinuar dhe eshte sipas te gjitha standarteve nderkombetare te aplikueshme per emetimin e ajrit.

Modelimi u krye si nje pjese e VIM per te vleresuar ndikimet e emetimit te ajrit ne cilesine e ajrit lokal. Rezultatet e modelimit tregojne qe Kompleksi do te jete sipas te gjitha standarteve nderkombetare te perqendrimit te cilesise se ajrit . Per me teper, modelimi tregon se impianti I planifikuar nuk do te shkaktoje degradim te cilesise se ajrit lokal apo te mjedisit.

Modelimi u krye gjithashtu si nje pjese e VIM per te vleresuar ndikimin e shkarkimit te lendes hidrokarbure Si permbledhje, impiantii I planifikuar eshte konform te gjitha standarteve nderkombetare per mjedisin dhe do te kete nje ndikim pozitiv ne ekonomine lokale pa sforcuar sherbimet dhe infrastrukturen lokale. Gjithashtu, impianti do te lehtesoje shume nga problemet emprehta qe po ndodhin aktualisht ne Shqiperi ne sistemin e transportit.

Planet e menazhimit dhe monitorimit

8- Rreziket e aksidenteve dhe projekteve te rrezikshme

8.1 Rreziket e aksidenteve, si p.sh. ato qe nuk mbulohen ne Direktiven e VNM, ose te Rregullimeve implementuese. Megjithate, kur projekti i propozuar perfshin materiale qe mund te jene te demshme per mjedisin (perfshire dhe njerezit) me ndodhjen e nje aksidenti, gjendja mjedisore duhet te perfshije nje indikacion te masave parandaluese qe do te adoptohen, ne menyre te tille qe nese ndodh nje gje e tille te mos shkaktoje nje ndikim te dukshem.

Stacioni i pershkruar me siper nuk shkarkon ne mjedis lende te demshme ne sasira te atilla qe mund te vinin ne diskutim funksionimin e tije

- Nuk prodhon mbetje te ngurta teknologjike
- Mbetjet e natyres urbane, qe prodhohen nga njerezit qe punojne aty, jane minimale.
- Instalimi elektrik i stacionit duhet te jete i tipit hermetik,
- Te zbatohen kerkesat per trashesine minimale te faqeve e rezervuareve, si vijon: kur diametric eshte deri ne 1750 mm, trashesia eshte jo me pake se 5 mm, kur diametri eshte nga 1751 deri ne 2000 mm, trashesia eshte jo me e vogel se 6 mm, e keshtu me rradhe (tabela nr.6)
- Ne kapakun e bokaportes se rezervuareve te vendosen pllaka me: emrin e prodhuesit, vitin e prodhimit, permasat dhe kapacitetin e rezervuarit
- Te gjitha linjat e hyrjes dhe te daljes, shkarkimit te avujve, matjes se nivelit, marrjes se kampioneve, etj. te dalin nepermjet kapakut te bokaportes.
- Rezervuaret duhet te vishen nga jashte me material antikorroziv dhe te vishen me material hidroizolues per ti mbrojtur nga korrozioni nenetokesor.
- Te gjitha tubot dhe anekset e tyre duhet te jene prej material! Te paoksidueshem. Ndalohet

perdorimi i tubove te zeza. Rekomandohet perdorimi i celikut inoksidabel.

- Linjat e ajrosjes dalin ne tufe paralele dhe sistemohen ne nje pike te caktuar.

Kokat e tubave duhet te jene kthyer nga poshte dhe te mbyllura me rrjete.

- Montimi i te gjitha tubacioneve dhe lidhjeve te tjera me rezervuaret si dhe me pompat e dhenies se karburantrt (distributore) duhet te behen me shume kujdes qe te sigurojne hermetizim te plote per te evituar (^o rrjedhje karburanti ne mjedis.

- Rezervuaret metalike duhet te tokezohen para lyerjes per mbrojtjen nga korrozioni.

- Rezervuaret mbushen maksimumi 10% me pake se volumi i tyre.

- Elektromotonrat e pompave (distributoreve) dhe te pompes se mbushjes se rezervuareve, duhet te jene te tipit hermetik dhe me rrotor me lidhje te shkurter.

- Ne thithje te linjes se distributoreve duhet te kete valvol moskthimi.

- Te pajiset stacioni me fikset perkatese te zjarrit ne pershtatje me rregulloren per kete qellim.

Do te mirembahen hidrantet dhe linjat e ujit ku do te sherbejne permbajtjen e ambienteve ne gjendje te gjelberuar.

-Me larte theksuam karburantet si produktet hidrokarbure si produkte qe dalin nga distilimi ne temperature dhe presione kalojne nga nje produkt ne tjetrin dhe nga nje gjendje fizike ne nje tjetere si rezultat i ndryshimit te temperatures,

Nga rritja e temperatures ne hapsirat e depozites nxjer ne pah fenomenin e avullimit ku rrit tensionin e avujve ne hapesiren gazore te cilet dalin ne atmosfere, duke ndikuar ne humbje te produktit. Rezervuaret jane parashkuar te pajisen me sisteme valvolash sigurie e shfryrje ose me sisteme kompensimi te presionit me qarkullim gazesh inerte ose hidrokarbure ne hapesiren gazore te rezervuareve. Do te ushtrohet kujdes qe ne rezervuaret e produkteve te lehta te benzinave temperatura do te mbahet ne nivelenormale nen 25 ° C. Kjo ne projekt eshte zgjidhur me nje system ftohes qarkullues uji ne kupolen e rezervuarit te benzines dhe te gazoilit kur temperatura kalon 40 °C, . Keteo masa jane mare mbasi keto fenomene jane prezente kur temperatura e mjedisit rritet mbi 25 ° C, sidomos gjate stines se veres,ndersakur temperatura e mjedisit eshte nen 25°C fenomeni i avullimit eshte jo i ndjeshem.

Te dhenat specifike per lendet e para

Tabela 1.- Lendet e para

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A përdorni lëndë të para?	po		Lendet e para qe perdoren jane, furnizimi me karburant dhe autogas me kapacitet depozitues 60 000 l BENZINE katg. II/A; Gazoil kat. III/A dhe 5000 litra GLN Katg.I/A
A përdorni materiale ndihmëse?		jo	
A përdorni përzjerje materialesh ?		jo	
A përdorni lëndë djegëse (dhe/ose energji)?		jo	
A përdorni kimikate laboratorike?		jo	
Lutemi rendisni materialet	1, 2, 3, etj.		

Shtojca 2

Tabela 2- Perdorimi /sigurimi i nenergjise

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A përdoret energji?	po		Perdoret energji elektrike 20kw per pompat e furnizimit, ndricim dhe nevoja te tjera sherbimi
A prodhohet kjo energji në territorin e impiantit?		jo	
A keni informacion tjetër?		jo	

Tabela 3- Konsumi i energjise dhe uji

Burimi	Konsumi ditor dhe total ne baze viti Kwh/g,t/g, dhe te ngjashme)
Energji elektrike	600 kw/ h ne muaj
KONSUMI I UJIT	Konsumi ditor dhe total baze 1-2 m3
Burimi i furnizimit	Kontrata OSHE & UKK
Rjeti publik	po
Puse personale	jo
Informacion sqarues	

MBROJTJA E OBJEKTIT

Per vete karakteristikat e punes sa objektit qe do te tregtoje lende lehtesisht te ndezshme, ne objekt jane parashikuar te rakodohen nje sere masash teknike dhe administrative per te siguruar mbrojtjendh sigurine e punes ne objekt:

1.Furnizimi me energji elektrike per nevoja motorike dhe te ndriçit behet nepermjet kabines elektrike 6/0.4 kw te vendasur ne atersi te objektit.

Shperndarja e rrjetit ushqyes te pajisjeve do te behet nga nje panel komandim. Fuqia e instaluar ashte 25w.

2.Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike dhe hidrostatike: per kate qellim jane parashikuar rrjetet etokezimit te objektit me shufra tokezimi zingato ne nyjet e lyre te ngulura ne toke. ne te gjithë siperfaqenMe kate rrjet do te lidhen te gjitha shkarkimet e objekteve qe ngrihen mbi siperfaqe. Eshte parashikuar sistem i veðante per mbrojtjen e rezervuareve. dhe per tokezimin e autoboteve gjate shkarkimit Te gjitha pajisjet dhe materialet e perdorura duhet te jene te certifikuara.

3.Mbrojtja nga Zjarri: Per vete natyren e materialeve qe do te tregtohen jane marre masa per respektimin e distancave,pozicionimin e pajisjeve dhe zgjedhjen e atrecaturave perkatese. Njekohesisht per masat brojtese kunder zjarrit eshte hartuar nje projekt i ve(fante .

4.Mbrojtja e ambienti nga ndotjet: Per mbrojtjen e ambientit jane marre masa per shmangien ne maksimum te humbjeve nga rrjedhje te mundshme ose avullime te produkteve.Vendosja e rezervuareve nen toke do te behet vetem pasi te jete bere prova hidraulike e tyre dhe e gjithë sistemit te tubacioneve.

Me pas ato do te Iyhen me boje antindryshkut dhe me boje bituminoze per ti rezistuar ambientit korroziv nen toke. Hermetizimi i kapakeve me guarnicione , furnizimi i secilit prej

tyre nga autoboti, nepermjet xhuntove hermetike, vendosja e tipit te distributorit bashkekohor, shmangin ne maksimum humbjet nga rrjedhjet ose pikimet. Gjithashtu vendosja e saturatorit ne linjen e shkarkimit te gazeve ,eliminon avujt e ngopur te hidrokarbureve te (flirohen jashte ne atmosfere.

Ka marreveshje me vete, ne fuqi, qe lidhen me mbajtjen ose perdorimin e substancave te rrezikshme, dhe Ekzekutivi per Shendetin dhe Sigurine, i siguron autoriteteve lokale te planifikimit keshillime rreth vleresimit te rrezikut mbi aplikimin e planifikimit qe perfshin nje instalim te rrezikshem.

Megjithate, eshte mire qe atje ku eshte e mundur, rreziku i aksidentit dhe i ndikimeve kryesore mjedisore, te konsiderohen se bashku, dhe qe projektuesit dhe autoritetet planifikuese, duhet ta kene gjithmone parasysh kete gje.

Ne funksionimin e ketij kompleksi nuke kemi te bejme me lende te rrezikshme qe duhet te kerkojne marveshje me ekzekutivin per mbejtjen e tyre per kete marveshjet me ekzekutivin lidhen vetem per transportin dhe depozitimin ssi dhe sshperndarjen periodike te lendeve hidrokarbure te cilat keto behn mbi bazen e nje licensimi nga orgsanet kopetente dhe ne cdo rast kompania eshte e detyruar te beje raportimet periodike gjate administrimit te Pikes se shitjes se karburanteve per mjetet motorrike.

15. DEKLARATË

DEKLARATË

Duke nënshkruar këtë deklaratë, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjit “Per lejet e mjedisit” dhe akteve nënligjore përkatëse unë paraqes kërkesën për leje mjedisi/ rishikimin e lejes së mjedisit.

Konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë kërkesë është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Unë nuk kam vërejtje lidhur me bërjen publike të kësaj Kërkesë , për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e legjilacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e të dhënave tregtare.

Emri i nënshkruesit: **Kadri DURAKU**

Pozicioni brenda Kompanisë **Administrator**

Firma:



Data 07 10/2021



Vula e
Kompanisë/Operatorit